Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë perkatese sipas legjislacionit ne fuqi, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

*(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

## Shtojca 12

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Përshkrim i punëve

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

**Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara

#### **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime

**SPECIFIKIMET TEKNIKE**

**RELACION TEKNIK**

**MIREMBAJTJE OBJEKTE NDERTIMORE**



B.Curri Janar 2021

## **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

Skicimet, parametrat teknik etj:

Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore është një shërbim i cili përmbledh këto riparime-shërbime për të gjitha godinat administrative, arsimore, ambjentet dhe repartet ndihmëse të Bashkisë Tropojë:

1. Riparime e mirëmbajtje me karakter ndertimor ku perfshihen zera punimesh nga çatite e taracat, ulluqet dhe kollonat e shkarkimit të ujrave, deri ne themelet e kanalizimet e ndertesave, suvatime, punimet në rruget dhe, trotuaret etj.
2. Riparime dhe punime mirëmbajtje me karakter hidraulik ku perfshihen: riparime mirëmbajtëse ne rrjetin e furnizimit me nga linja kryesore ose kolektorin qytetës deri ne rubinetin e fundit (paisjen e fundit), riparime mirëmbajtëse ne rrjetin e shkarkimit të ujrave të bardha dhe të zeza duke filluar nga lavaman-ët, ne rrjetin e kanalizimeve jashte ndertesave dhe deri ne lidhjen me kolektoret e qytetit, çbllokimin e të gjithë nyjeve sanitare dhe pusetave ne ndertesave dhe rrugore dhe riparime mirëmbajtëse ne rrjetin e ngrohjes nga dalja e kaldajes deri ne radiatorin e fundit ngrohës.
3. Riparime dhe punime mirëmbajtje me karakter elektrik, ku perfshihen: riparime mirëmbajtëse ne rrjetin e TU nga dalja e kabines TM (gjeneratorit) deri ne konsumatorin e fundit llampë, prize; riparime mirëmbajtëse në kasetat dhe kuadrot elektrik brenda ndertesave, riparime ne paisjet ngrohëse elektrike si radiatorët, riparime mirëmbajtëse ne rrjetin e ndriçimit rrugor.
4. Riparime e punime mirëmbajtje druri-hekuri e marangozi ku perfshihen punime për riparim e mirëmbajtje dyert-dritare, vetrata d.alumini, dollape, rafte, karrike, tavolina, stola, brava, kasaforta, kangjella, zevendesim xhama të thyer, etj.
5. Lyerje me gelqere, hidroplastike, boje vaji, bojë uji të të gjithë siperfaqeve të ndertesave me boje antindryshk dhe zmalto. Lyerjet zbatohen sipas normave teknike.
6. Organizimin dhe kryerjen e shërbimit të gatishmërisë për defekte elektrike, hidraulike-ç'bllokuese dhe ngrohjeje (për sezonin e ngrohjes) gjatë gjithë ditëve kalendarike.

Të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, duhet të jenë të çertifikuara (CE).

### **Procedura e zbatimit:**

Përgjegjësi i Sektorit të Ndjekjes së Shërbimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore, ndjek nëpërmjet specialistëve teknik/asistent-teknikëve mbarëvajtjen e punës, sipas urdhrave të punës së hapur si dhe grafikëve të punimeve sipas prioriteteve, për kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes ndërtimore, në godinat administrative dhe arsimore.

Specialisti/As.tekniku njihet çdo ditë me problematikat teknike si dhe anomalitë e shfaqura në ambientet e objekteve ndertimore që mbulon, nëpërmjet “urdhërave të punës” të hapur cdo ditë

nga Drejtoria e Sherbimeve pranë bashkisë Tropojë, për godinat që mbulojnë, si dhe për ambjentet e tjera nga specialistët e Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore, duke ia dhënë sipërmarrësit për zbatim, i cili nënshkruan marrjen në dorëzim të këtijurdhri dhe mban kopjen përkatëse.

Urdhrat e Punës, përvec llojit të punimit do përmbajë edhe vendin se ku do kryhet ky punim, afatin kohor të kryerjes së punimit, nga data e lëshimit.

Gjatë kohës së punës, bazuar në urdhrat e punës të lëshuara nga Drejtoria e Sherbimeve si dhe specialistet e Sektorit të Ndjekjes së Investimeve, te bashkisë, as.tekniku ndjek riparimin e defekteve në kohë dhe cilësi, dhe i pasqyron ato në kopjen e “urdhërit të punës”, ku duhet të nënshkruajë, drejtuesi i institucionit përkatës, përfaqësuesi i sipërmarrësit dhe në fund administratori/ specialist i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore, te Drejtorisë së Sherbimeve, për konfirmimin e tyre.

Këto urdhëra pune të plotësuara me nënshkrimet e mësipërme, shërbejnë si bazë për hartimin e situacionit mujor që shoqëria sipërmarrëse, dorëzon për konfirmim cdo muaj pranë Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore.

Përgjegjësi i Sektorit, bazuar në nevojat dhe kërkesat e Shërbimeve Arsimore harton dhe miraton garfikut e riparimeve mirëmbajtëse të programuara, ku futen lysterjet me gëlqere, hidro plastikë, boje vaji, bojë uji, riparime ndërtimore, hidrosanitare, elektrike, të marangozit, sistemit të ndricimit të jashtëm dhe të brendshëm, punime të tarracave dhe cative, mirëmbajtje catish, mirëmbajtje dhe riparim pusetash, riparime të rrugëve të brendshme asfalte dhe trotuare, sistem shpërndarje ngrohje brenda godinave dhe në kolektorët kryesorë nga dalja e kaldajave në godina administrative apo arsimore qe jane te paisura me system ngrohje.

Përgjegjësi i Sektorit, në bashkëpunim me Sipërmarrësin, organizojnë shërbimin e mirëmbajtjes ndërtimore në të gjithë godinat adminiostrative, arsimore dhe kulturore në të gjitha ditët e javës duke përfshirë të shtunën dhe të dielën, referuar zërave të punimeve që përmban preventivi, bazuar në urdhrat e punës të hapur nga administratoret përgjatë ditëve të javës, dhe referuar nevojave të shërbimeve ne keto objekte.

Libreza e masave, përmbledh të gjithë urdhërat e punës të zbatuara gjatë muajit, të cilët janë të firmosura nga as.tekniku dhe përgjegjësi i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore, si dhe përfaqësuesi i sipërmarrësit, duke pasqyruar punimet e kryera. Në këto dokumente pasqyrohen emërtimi i shërbim-riparimit të kryer, njësia e matjes, data e kryerjes/ përfundimit të punimit, dhe sasia e kryer.

Subjekti zbatues i punimeve, në bazë të çmimeve të përfshira në kontratën e zbatimit të punimeve, harton situacionin me vleftë dhe në bazë të situacionit nënshkruan faturën për pagesë. Bashkangjitur situacionit mujor, sipërmarrësi duhet të dorëzojë librezën e masave përkatëse të këtij situacioni, ditarin e punimeve të objekteve si dhe grafikun e punimeve të zbatuara. Vetëm me dorëzimin e dokumentacionit të sipër përmendur do firmoset situacioni me faturën tatimore përkatëse.

Në rast se sipërmarrësi, nuk zbaton urdhërat e punës brenda afateve të përcaktuara në to, as teknikët janë personat përgjegjës, që së bashku me Përgjegjësin e Sektorit të Shërbimeve mbajnë proces verbalin e gjobës të cilin ia paraqesin Drejtorit në Drejtorinë e Shërbimeve nëpërmjet një relacioni me dokumentacionin përkatës justifikues ( urdhra pune të pa zbatuara), ku ky i fundit ia dërgon me shkresë Drejtorisë Ekonomike për zbatim.

Nisur nga rëndësia kryesisht në shkollë, në të cilin bëjnë pjesë edhe punimet laboratorike, të cilat kërkojnë energji elektrike, ujë, temperaturë të përcaktuar të ambientit, shkarkime të ujrave të përdorur etj, të sigurta e cilësore, sipërmarrësi duhet të ketë specialistë të kalifikuar dhe të sigurojë gadishmërinë e sistemeve dhe rrjeteve furnizuese dhe shpërndarëse të energjisë, ujit, ujittë ngrohtë , kanalizimeve etj, gjatë gjithë javës mësimdhënies.

**Specialitet e firmës sipërmarrëse, duhet të kenë uniformën dhe paisjet përkatëse personale për sigurinë teknike në punë, dokumentin identifikues dhe sjellja e tyre duhet të jetë e pershtatshme për ambientet administrative apo arsimore. Instruktimi teknik në punë, është përgjegjësi e sipërmarrësit.**

## SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

<b>TABELA PËRMBLEDHËSE</b>		<b>(2021)</b>
<b>NR.</b>	<b>EMËRTIMI I SHËRBIMIT</b>	<b>Çmimi neto ( lekë)</b>
I	PUNIME PRISHJE	
II	PUNIME MURATURE E BETONE	
III	PUNIME SHITESH	
IV	PUNIME PSUVA E BOJATISJE	
V	PUNIME IZOLIMI E ÇATIE	
VI	PUNIME DYER DRITARE	
VII	PUNIME MARANGOZI	
VIII	PUNIME MIRMBAJTJE RR/EHIDRAULIKE	
IX	PUNIME MIRMBAJTJE RR/ELEKTRIK	
	<b>TVSH 20%</b>	
	<b>ÇMIMI TOTAL ME TVSH</b>	

Afatet e ekzekutimit:

### **Kohëzgjatja e shërbimit të mirëmbajtjes është deri në 31 dhjetor 2021**

Nisur nga sa përshkruhet më sipër hartohet edhe grafiku i lëvrimit:

Për riparim të defekteve lëshohet “Urdhër pune” tip, i cili përmban sasinë e punimeve, vendin ku do të kryhet punimi dhe afatin e kryerjes nga data e lëshimit.

Urdherat e punës lëshohen sipas nevojave të shërbimeve administrative apo arsimore. Specialisti/As.tekniku njihet çdo ditë me problematikat teknike si dhe anomalitë e shfaqura në objektet ndertimore që mbulon, nëpërmjet “urdhërave të punës” të hapur cdo ditë nga cdo Drejtoria e Sherbimeve, për godinat që mbulojnë, si dhe për ambjentet e tjera nga specialistët e Sektorit të Sherbimeve, duke ia dhënë sipërmarrësit për zbatim, i cili nënshkruan marrjen në dorëzim të këtij urdhri dhe mban kopjen përkatëse.

Gjatë kohës së punës, bazuar në urdhrat e punës të lëshuara nga Drejtoria e Sherbimeve si dhe specialist i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve, as.tekniku ndjek riparimin e defekteve në kohë dhe cilësi, dhe i pasqyron ato në kopjen e “urdhërit të punës”, ku duhet të nënshkruajë, administratori i objektit perkates (Drejtori i Shkolles apo Institucionit) përfaqësuesi isipërmarrësit dhe në fund administratori/ specialist i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore, prane bashkisë, për konfirmimin e tyre.

Këto urdhëra pune të plotësuara me nënshkrimet e mësipërme, shërbejnë si bazë për hartimin e situacionit mujor që shoqëria sipërmarrëse, dorëzon për konfirmim cdo muaj pranë Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore.

Përgjegjësi i Sektorit të Sherbimeve, bazuar në nevojat dhe kërkesat e Shërbimeve harton dhe miraton, garfikut e riparimeve mirëmbajtëse të programuara, ku futen lyerjet me gëlqere, hidro plastikë, boje vaji, bojë uji, riparime ndërtimore, hidrosanitare, elektrike, të marangozit, sistemit të ndricimit të jashtëm dhe të brendshëm, punime të tarracave dhe cative, mirëmbajtje catish, mirëmbajtje dhe riparim pusetash, riparime të rrugëve të brendshme asfalte dhe trotuare, sistem shpërndarje ngrohje brenda godinave dhe në kolektorët kryesorë nga dalja e kaldajave në godina administrative apo arsimore.

Përgjegjësi i Sektorit, në bashkëpunim me Sipërmarrësin, organizojnë shërbimin e mirëmbajtjes ndërtimore në të gjithë godinat e bashkisë Tropojë, në të gjitha ditët e javës duke përfshirë të shtunën dhe të dielën, referuar zërave të punimeve që përmban preventivi, bazuar në urdhrat e punës të hapur përgjatë ditëve të javës, dhe referuar nevojave të shërbimeve.

Libreza e masave, përmbledh të gjithë urdhërat e punës të zbatuara gjatë muajit, të cilët janë të firmosura nga as.tekniku dhe përgjegjësi i Sektorit të Ndjekjes së Investimeve dhe Mirëmbajtjes Ndërtimore, si dhe përfaqësuesi i sipërmarrësit, duke pasqyruar punimet e kryera. Në këto dokumente pasqyrohen emërtimi i shërbim-riparimit të kryer, njësia e matjes, data e kryerjes/ përfundimit të punimit, dhe sasia e kryer.

Subjekti zbatues i punimeve, në bazë të çmimeve të përfshira në kontratën e zbatimit të punimeve, harton situacionin me vleftë dhe në bazë të situacionit nënshkruan faturën për pagesë. Bashkangjitur situacionit mujor, sipërmarrësi duhet të dorëzojë librezën e masave përkatëse të këtij situacioni, ditarin e punimeve të objekteve si dhe grafikun e punimeve të zbatuara. Vetëm me dorëzimin e dokumentacionit të sipër përmendur do firmoset situacioni me faturën tatimore përkatëse.

Në rast se sipërmarrësi, nuk zbaton urdhërat e punës brenda afateve të përcaktuara në to, as.teknikët janë personat përgjegjës, që së bashku me Përgjegjësin e Sektorit të Sherbimeve dhe Administratorin e objektit për të cilin është lëshuar Urdhëri i Punës, mbajnë proces verbalin e gjobës të cilin ia paraqesin Drejtorit në Drejtorinë e Shërbimeve, nëpërmjet një relacioni me



dokumentacionin përkatës justifikues ( urdhra pune të pa zbatuara), ku ky i fundit ia dërgon me shkresë Drejtorisë Ekonomike për zbatim.

Nisur nga rëndësia kryesishte ne shkolla, në të cilin bëjnë pjesë punime laboratorike, të cilat kërkojnë energji elektrike, ujë, temperaturë të përcaktuar të ambientit, shkarkime të ujrave të përdorur etj, të sigurta e cilësore, sipërmarrësi duhet të ketë specialistë te kalifikuar dhe të sigurojë gadishmërinë e sistemeve dhe rrjeteve furnizuese dhe shpërndarëse të energjise, ujit, ujittë ngrohtë , kanalizimeve etj, gjatë gjithë javës mësimdhenies.

Specialitet e firmës sipërmarrëse, duhet të kenë uniformën dhe paisjet përkatëse personale për sigurinë teknike në punë, dokumentin identifikues dhe sjellja e tyre duhet të jetë e pershtatshme për ambientet administrative apo arsimore. Instruktimi teknik në punë, është përgjegjësi e sipërmarrësit.

## **TERMAT E REFERENCËS**

Bashkia Tropojë ka nje numer te konsiderueshem objektesh ndertimore qe duhet te mirëmbahen gjate gjithë vitit si ne qender apo ne qytetin e Bajram Curritashtu dhe ne 7 njesit administrative te shperndara ne gjithë rrethin territorin e rrethit ku specifikojme disa pre tyre si me poshte vijon:

### **1. Godina e Bashkia Tropoje**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në pjesën qendrore te qytetit B.Curri

*Funksioni:* Shërbim administrativ

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1974-1975.

*Nr Kateve :* 4 kate me siperfaqe totale te kateve 4800 m<sup>2</sup>

*Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin 2017*

### **2. Pallati i Kultures**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në pjesën perendimore të qytetit

*Funksioni:* Shërbim kultur

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1974-1976.

*Nr Kateve :* 4 kate me siperfaqe totale te kateve 2500 m<sup>2</sup>

*Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin 2016*

### **3. Muzeu Historik**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qender te qytetit

*Funksioni:* Shërbimi i Kultur

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1978-1984.

*Nr Kateve :* 3 kate me siperfaqe totale te kateve 3500 m<sup>2</sup>

*Rikonstruksioni i fundit ka qënë i pjesshem në vitin 2004*

#### **4. Bibloteka e qytetit**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qender te qytetit

*Funksioni:* Shërbimi i Kulturor dhe arsimor  
*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1964-1965.

*Nr Kateve :* 2 kate me sipërfaqe totale te kateve 1260 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë i pjesshem në vitin 1998

#### **5. Godinat e Konviktit**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në pjesën perendimore te qytetit

*Funksioni:* Aktualisht perdoret si Zyra administrate te UK dhe ambiente ndimse  
Te bashkise dhe per strehim social.

*Mosha:* ndërtuar ne vitin 1960 .

*Nr Kateve :* 4 kate me sipërfaqe totale te kateve 6200 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit : ne vitin 2012 .

#### **6. Pallati i Sportit**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në pjesën Veriore te qytetit

*Funksioni:* Sportive e Kulturore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1990-1995.

*Nr Kateve :* 1 kate me sipërfaqe totale te kateve 1600 m<sup>2</sup> Perfundimi  
i plote i ndertimit me shkalle stadium,shtresa,suvatime, instalime  
elektrike e h/sanitare e vendsje xhamlliku eshte në vitin 2013.

#### **7. Shkolla e Mesme Asim Vokshi**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në pjesën Veriore te qytetit

*Funksioni:* Edukimi Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1988-1989.

*Nr Kateve :* 4 kate me sipërfaqe totale te kateve 2495 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin 2018.

#### **8. Palestra Sportive**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në pjesën Veriore te qytetit

*Funksioni:* Edukimi Sportiv

*Mosha:* ndërtuar ne vitin 2019-2020.

*Nr Kateve :* 1 kate me sipërfaqe totale 2670 m<sup>2</sup>

### **9. Shkolla 9-vjecare “Ali Podrimja”**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në pjesën Veriore të qytetit

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar në vitet 2011-2012.

*Nr Kateve :* 4 kate me sipërfaqe totale të kateve 5990 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin\_\_\_\_\_.

### **10. Shkolla “Beslidhja e Malsisë”**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në pjesën Perendimore të qytetit

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1975-1985 .

*Nr Kateve :* 4 kate me sipërfaqe totale të kateve 10140m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin 2008.

### **11. Shkolla “Konferenca e Bujanit”**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në pjesën Perendimore të qytetit

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar në vitet 1970-1975.

*Nr Kateve :* 3 kate me sipërfaqe totale të kateve 1600m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin 2005.

### **12. Godina e Kopshtit Nr.1**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qendër të Lagjes “Partizani” B.Curri.

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1980-1985.

*Nr Kateve :* 3 kate me sipërfaqe totale të kateve 1650m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin 2004.

### **13. Godina e Kopshtit Nr.2**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qendër të Lagjes “Partizani” B.Curri.

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1970-1975.

*Nr Kateve :* 2 kate me sipërfaqe totale të kateve 2400 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin 2018.

#### **14. Godina e Cerdhes**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në pjesën Jugore të qytetit B.Curri.

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1978-1980.

*Nr Kateve :* 2 kate me sipërfaqe totale të kateve 1460 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin 2017.

#### **15. Shkolla e Mesme Firze**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qendër të Qyteti Fierze

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1980-1982.

*Nr Kateve :* 3 kate me sipërfaqe totale të katit 2520 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin 2016.

#### **16. Shkolla e Mesme Llugaj**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qendër të fshati Llugaj, Nj.Administrative Llugaj

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1925-1935.

*Nr Kateve :* 2 kate me sipërfaqe totale të kateve 1560m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin 2006.

#### **17. Shkolla e Mesme Tropoje (Aste)**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qendër të fshatit Aste.

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1970-1975.

*Nr Kateve :* 3 kate me sipërfaqe totale të katit 2140 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë para viteve 2007.

#### **18. Shkolla e mesme Pac**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në afërsi të qendër të Nj. Administrative Bytyç.

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1983-1985.

*Nr Kateve :* 2 kate me sipërfaqe totale të katit 1420 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë në vitin 2016 .

### **19. Shkolla e mesme Zogaj**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qender te Fshatit Zogaj Nj.A. Bytyç.

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1985-1987.

*Nr Kateve :* 2 kate me sipërfaqe totale te katit 1420 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë ne vitin 2001.

### **20. Shkolla 9-vjecare Bujan**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në afersi te qenders se Nj. Administrative Bujan.

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1976-1980.

*Nr Kateve :* 2 kate me sipërfaqe totale te katit 1420 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë ne vitin 1998.

### **21. Shkolla 9-vjecare T'pla**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qender te Fshartit T'pla Nj.A. Fierze.

*Funksioni:* Edukimi Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1978-1981.

*Nr Kateve :* 2 kate me sipërfaqe totale te katit 1060 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë ne vitin 2004 .

### **22. Shkolla 9-vjecare Bucaj**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qender te Fshartit Papaj Nj.A. Tropoje.

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1985-1988.

*Nr Kateve :* 2 kate me sipërfaqe totale te katit 1090 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë ne vitin 2004.

### **23. Shkolla 9-vjecare Kerrnaie**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qender te Fshartit Hoxhaj Nj.A. Tropoje.

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1978-1979.

*Nr Kateve :* 1 kate me sipërfaqe totale te katit 640 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë ne vitin 2007 .

### **24. Shkolla 9-vjecare Cernice**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qender te Fshartit "Jaho Salihi" Nj.A. Lulugaj.

*Funksioni:* Edukimi Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1980-1981.

*Nr Kateve :* 2 kate me sipërfaqe totale te katit 1010 m<sup>2</sup>  
Rikonstruksioni i fundit ka qënë ne vitin 2004 .

## **25. Shkolla 9-vjecare Babine**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qender te fshatit Babin Nj.Administrative Tropoje

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1985-1986.

*Nr Kateve :* 3 kate me sipërfaqe totale 1842 m<sup>2</sup>

Rikonstruksioni i fundit ka qënë ne vitin 2007.

## **26. Shkolla 9-vjecare Lekbibaj**

*Pozicionimi:* Lokalizuar në qender te Nj.Administrative Lekbibaj.

*Funksioni:* Objekt me funksion Arsimore

*Mosha:* ndërtuar rreth viteve 1978-1979.

*Nr Kateve :* 2 kate me sipërfaqe totale 1800 m<sup>2</sup>

Rikonstruksioni i fundit ka qënë ne vitin 2019.

### **Mirmbajtja e Urave**

Riparime te Urave Kemsore e atyre Tip “BELI” ne gjithë territorin e bashkise Tropoje.

### **Mirmbajtja e shkollave te tjera**

-Mirmbajtja e gjithë shkollave fillore ne fshatrat e pa pershkruara me lartet qe jane ne funksion sote si shkolla fillore.

### **Mirmbajtja e objekteve Administrative**

-Mirmbajtja e gjithë qendrave te Njesive Administrative te Bashkise Tropoje.

Për vetë specifikën që kanë, kërkohen standarte në kryerjen e punimeve të ndryshme sipas problematikës, që të mos pengojë zhvillimin e mësimdhenies, por dhe ti kryejë në kohë dhe në cilësi. Këto godina furnizohen në mënyra të ndryshme me energji, ujë dhe ngrohje, si dhe kanë sistemet e shkarkimit të ujrave të përdorura, të ndryshme ku disa prej tyre jane me gropa septike. Mirëmbajtja e objekteve ndërtimore është një shërbim i cili përmbledh këto riparime-shërbime për të gjitha godinat administrative dhe arsimore te bashkisë Tropojë:

1. Riparime e mirëmbajtje me karakter ndertimor ku perfshihen zera punimesh nga çatite e taracat, ulluqet dhe kollonat e shkarkimit të ujrave, deri ne themelet e kanalizimet e ndertesave, suvatime, punimet në rruget dhe, trotuaret etj.
2. Riparime dhe punime mirëmbajtje me karakter hidraulik ku perfshihen: riparime mirëmbajtëse ne rrjetin e furnizimit me uje nga dalja ne stacionin e pompave ose kolektorin qytetës deri ne rubinetin e fundit (paisjen e fundit), riparime mirëmbajtëse ne rrjetin e shkarkimit të ujrave të bardha dhe të zeza duke filluar nga lavaman-ëc, ne rrjetin e kanalizimeve jashte ndertesave dhe deri ne lidhjen me kolektoret e qytetit, çbllokimin e të gjithë nyjeve sanitare dhe pusetave ne ndertesat dhe rrugore dhe riparime mirëmbajtëse ne rrjetin e ngrohjes nga dalja e kaldajes deri ne radiatorin e fundit ngrohës.
3. Riparime dhe punime mirëmbajtëse me karakter elektrik, ku perfshihen: riparime mirëmbajtëse ne rrjetin e TU nga dalja e kabines TM (gjeneratorit) deri ne konsumatorin e fundit llampë, prize; riparime mirëmbajtëse në kasetat dhe kuadrot

## Dokumenta Standarde të Tenderit

elektrik brenda ndërtesave, riparime ne paisjet ngrohese elektrike si radiatorët, riparime mirëmbajtëse ne rrjetin e ndriçimit rrugor.

4. Riparime e punime mirëmbajtje druri-hekuri e marangozi ku perfshihen punime për riparim e mirmbajtje dyert-dritare, vetrata d.a., dollape, rafte, karrike, tavolina, stola, brava, kasaforta, kangjella, zevendesim xhama të thyer, etj.
5. Lyerje me gelqere, hidroplastike , boje vaji, bojë uji të të gjithë siperfaqeve të ndërtesave me boje antindryshk dhe zmalto. Lyerjet zbatohen sipas normave spitalore.

**Të gjitha materialet që përdoren për riparime dhe furnizim vendosje, duhet të jenë të certifikuara (CE).**

**Kohëzgjatja e shërbimit do të jetë deri më 31 Dhjetor 2021.**

# Dokumenta Standarde të Tenderit

## Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Objekti : Mirmbajtje objektesh Ndertimore

N r	N/analiz e	Emertimi i Punimeve	Njesi a	Sasi a	Çmimi	Vler a
<b>I. PUNIME PRISHJE</b>						
1	2.1	Germim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria III	m3			
2	2.426	Prishje mur tulle pa pastrim	m3			
3	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3			
4	2.426/4	Prishje soleta b/a	m3			
5	An	Prishje shtrese pllakash	m2			
6	An	Prishje H/Izolimi	m2			
7	An	Prishje Suvatimi	m2			
8	An	Prishje Struktur e lehte çatie	m2			
9	2.37/2a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 2.0 km	m3			
<b>Shuma 1</b>						
<b>II. PUNIME MURATURE E BETONE</b>						
1	2.64/1	Mur me tulle plota ne lartesi deri 3m me llaç perzier M 15	m3			
2	2.68	Mur tulle te plota kollone deri 3m me llaç perzier M 15	m3			
3	2.70/2	Mur me tulle te lehtesuara dopio deri 3m me llaç perzier M25	m3			
4	2.86	Mur me tulle me 6 vrima, t=12cm, h~3m, llaç perzier M15	m3			
5	2.109/2	Themel e xokol betoni C - 12/15	m3			
6	2.119/1	Trare e arkitrare b/a C - 16/20, h ~ 4 m	m3			
7	2.117/1	Kollona b/a monolite C - 16/20, h ~ 4 m	m3			
8	2.121/1	Brez b/a C 16/20, h ~ 8 m	m3			
9	2.122/1a	Soleta te plota b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m	m3			
10	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton			



## Dokumenta Standarde të Tenderit

11	2.167	F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm	ton			
12	2.181	Konstruksione metalike te perbera	ton			
		<b>Shuma 2</b>				
		<b>III. PUNIME PRISHJE</b>				
1	2.288	Trotuar me pllaka granili me boje pa borduren e betonit	m2			
2	2.291	Bordura trotuari 25x12cm te derdhura ne vend	ml			
3	An	Riparim Shtrese Trotuari	m2			
4	2.258	Nenshtrese zhavori	m3			
5	2.261	Shtrese rere	m3			
6	2.262	Shtrese betoni C 6/10	m3			
7	2.264	Shtrese lluster çimento 1:2	m2			
8	2.267/b	Shtrese me pllaka grez importi 40 x 40 cm	m2			
9	2.271	Shtrese mozaik mermeri t = 20 mm	m2			
10	2.273/1	Shtrese pllaka mermeri t = 30 mm	m2			
11	2.267/a	Shtrese me pllaka grez porcelanato	m2			
12	2.276	Shtrese parketi	m2			
13	2.279	Shtrese derrasa FM 2.5cm	m2			
14	2.276	Shtrese parketi laminat	m2			
15	2.268a	Shkalle mermer montazhi	m2			
16	2.284	Shtrese dyshemeje me meneline	m2			
		<b>Shuma 3</b>				
		<b>IV. PUNIME MIRMB. TAVANI, SUVA E BOJATISJE</b>				
1	2.292	Trare tavani te sharruar	m2			
2	2.297/b	Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm	m2			
3	2.297/c	Tavan i varur plastik	m2			
4	2.297/a	Tavan i varur me kartonxhes	m2			
5	2.326	Veshje me pllake majolike	m2			
6	2.300	Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah	m2			
7	2.310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25	m2			
8	2.312	Suva brenda mur guri h~4m me krah, llaç perzier M 25	m2			
9	2.314	Suva trare e kollona h~4m me krah me llaç perzier M 25	m2			

## Dokumenta Standarde të Tenderit

10	2.324/b	Plintuse grez importi, h = 10 cm	ml			
11	2.328	Patinim muri allçi (stuko)	m2			
12	2.330	Patinim tavani allçi (stuko)	m2			
13	2.331	Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m	m2			
14	2.332	Suva e zakonshme fasade mur guri h ~ 8 m	m2			
15	2.350	Suva xokoli me granil e çimento te zakonshme me spruco	m2			
16	2.308/a	Suvatim me grafiato h > 4 m	m2			
17	2.358/d	Veshje muri me kartonxhes cimentato	m2			
18	2.399	Sherbetisje e bojatisje me gelqere	m2			
19	2.400	Boje vaji siperfaqe druri	m2			
20	2.401	Boje vaji siperfaqe metalik	m2			
21	2.403	Boje vaji mbi siperfaqe te patinuar	m2			
22	2.404	Boje hidroplastike	m2			
23	2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e I-re	m2			
		<b>Shuma 4</b>				
		<b>V. PUNIME MIRMBAJTJE H/IZOLIMI E ÇATIE</b>				
1	2.195	Hidroizolim me emulsion dhe dy duar bitum	m2			
2	2.196	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese k katrama	m2			
3	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama	m2			
4	2.200	Shtrese lluster cemento 1:2, t = 20 mm	m2			
5	2.203	Veshje kornize llamarine xingat	m2			
6	2.206	Kasete shkarkimi me llamarine xingat	cope			
7	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 mm	ml			
8	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33 cm	ml			
9	2.219	Çati vendi zakonshme HD~8m, mbuluar, tjegulla marseleze	m2			
10	An	Çati vendi zakonshme HD~8m, mbuluar, llamarin Xingato	m2			
11	2.256/b	Mbulim çatie me tjegulla marseljeze	m2			
12	An	Mbulim çatie me llamarin xingato	m2			
13	An	Mbulim çatie me llamarin imitim tjegull	m2			
14	2.256/b	Mbulim çatie me panele sandwich	m2			

## Dokumenta Standarde të Tenderit

15	2.431	Skele metalike me tubo fasade > 12m	m2			
16	2.407	Pllake b/a granili mbi parapet tarace	m2			
17	2.409	Parapet shkalle e ballkone mur tulle+suva+koriman druri	m2			
18	2.420	Pergatitje e vendosje lende e rumbullaket	m3			
19	2.421	Pergatitje e vendosje lende e sharruar	m3			
20	3.415/3	Shtese me derrasa, t= 5 cm per Ura Druri	m2			
		<b>Shuma 5</b>				
		<b>VI. PUNIME DYER DRITARE</b>				
1	3.370	F.V dritare druri kase binar, teke xham	m2			
2	3.375	Dritare d/alumini tek xham.	m2			
3	2.375/a	Dritare d/alumini dyfish xham.	m2			
4	2.395	Dyer d/alumini tek xham.	m2			
5	2.395/a	Dere d/alumini pa xham,me mbushje d/a.	m2			
6	2.390/1	F.V dyer metalike me llamarine te zeze 27.75 kg/m2	m2			
7	2.375/1	F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m2			
8	2.395/1	F V dyer d/alumini plastike me dopio xham	m2			
9	2.383/1	F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I-re.	m2			
10	2.386/1	F V dyer te brendeshme metalike te blinduara.	m2			
11	2.373	Vetrato xhami i temperuar	m2			
12	2.388/1	V F dyer te brendeshme tamburate te rimesuara	m2			
13	2.405	Pragje dritare me pllake granili te armuar me boje	m2			
14	2.413	F.V zgara dekorativa hekuri me figuracion mesatare	ton			
		<b>Shuma 6</b>				
		<b>VII. RIPARIM E MIRËMBAJTJE MARANGOZI</b>				
1	An	Rip. çatie (eliminim lageshtire, zevendesim tjegullash)	m2			
2	An	Furr. Vendorsje rrjete mbrojtese per insektet	m2			
3	An	Furr. Vendorsje mbrojtse te kendeve inoksi	ml			
4	An	Furr.vend. Bravë e thjeshte per dere druri	cope			

## Dokumenta Standarde të Tenderit

5	An	Furr.vend. Bravë e zakonshme per dere druri	cope			
6	An	Furr.vend. Bravë sirtaresh	cope			
7	An	Furr.vend. Doreza dyersh druri	cope			
8	An	Furr.vend. Bravë per dere te blinduar	cope			
9	An	Furr.vend. Bravë sekrete (me çeles nga nje ane)	cope			
10	An	Furr.vend. Bravë e thjeshte per dyer d/alumini	cope			
11	An	Furr.vend. Fisheke brave per dyer d/alumini	cope			
12	An	Furr.vend. Doreza dyersh d/alumini	cope			
13	An	Furr.vend. Fisheke brave per dere te blinduar	cope			
14	An	Furr.vend. Fisheke brave sekrete	cope			
15	An	Furr.vend.mentesha per dyer dritare druri	cope			
16	An	Furr.vend.mentesha per dyer dritare d/alumini	cope			
17	An	Furr.vend. Doreza per dritare	cope			
18	An	Furr.vend. Xham i thjeshte	m2			
19	An	Furr.vend. Xham i akull	m2			
20	An	Furr.vend.dopi Xham per dyer-dritare	m2			
21	An	Riparim dyer e dritare derrase	m2			
22	An	Furr.vend. Elem. derrase C-I-re per stola amb.jashtme	ml			
23	An	Riparim dyer e dritare d/alumini	op			
24	An	Riparime marangozi dollap. Tavolina, karrike korniza	op			
25	An	Riparime me saldim kangjella, tavolina, raftie etj	op			
26	An	Riparim koka oxhaqesh	cope			
27	An	Pastrim e çbllokim i oxhaqeve	cope			
28	An	Furr. Vendorsje Vegla pune me bishta	cope			
29	An	Furr. Vendorsje bishta flamujsh	cope			
30	An	Furr. Vendorsje Stenda Dekori	cope			
		<b>Shuma 7</b>				
		<b>VIII. RIPARIM E MIRËMBAJTJE HIDRAULIKE</b>				

## Dokumenta Standarde të Tenderit

1	2.491	F.V tub xingato dhe rakorderi Ø ~ 1 "	kg			
2	2.492	F.V tub xingato dhe rakorderi Ø > 1 "	kg			
3	2.494	F.V saracineska bronzi Ø 1/2 " = 15 mm	cope			
4	2.494/1	F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm	cope			
5	2.494/2	F.V saracineska bronzi Ø 1 " = 25 mm	cope			
6	2.494/5	F.V saracineska bronzi Ø 2 " = 50 mm	cope			
7	2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator	cope			
8	2.501	F.V WC allafrenga importi	cope			
9	2.504	F.V WC allaturka importi	cope			
10	2.491/1a	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=20mm, t = 2.3 mm, PN 20	ml			
11	2.491/1b	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=25mm, t = 3.0 mm, PN 20	ml			
12	An - 9	F.V Saraçineske PPR 1/2"	cope			
13	An - 10	F.V Saraçineske PPR 3/4"	cope			
14	2.516/1	F.V Tuba e rakorderi PVC	kg			
15	An - 15	F V bolier 80 liter, uje te ngrohte	cope			
16	2.514	F.V pilete dysHEMEJE Ø 40 mm	cope			
17	An	Furr. Vend. Tuba fleksibel 30 ~ 40 cm	cope			
18	An	Furr. Vend. Tuba fleksibel 50 ~ 60 cm	cope			
19	An	Furr. Vend. Sifon lavamani	cope			
20	An	Furr. Vend. grup lavamani thjeshte (me tuba e montuese)	cope			
21	An	Furr. Vend. grup lavamani C e I-re (me tuba e montuese)	cope			
22	An	Furr. Vend. Lavama pa kollon (pa grup e sifon)	cope			
23	An	Furr. Vend. Rubineta uji 1/2" te thjeshta	cope			
24	An	Furr. Vend. Rubineta uji 1/2" C e I-re	cope			
25	An	Furr. Vend. Tub shkarkimi per kaseta	cope			
26	An	Furr. Vend. Kaseta shkarkimi plastike	cope			
27	An	Furr. Vend. Galixhan per kaseta wc	cope			
28	An	Furr. Vend. Rezistence boljeri	cope			
29	An	Furr. Vend. termostat boljeri	cope			
30	An	Furr. Vend. Element radiatori me llamarine 60 x 80	cope			
31	An	Furr. Vend. Rekorderi xingato	kg			
32	An	Furr. Vend. Hollandez xingato 1/2"	cope			

## Dokumenta Standarde të Tenderit

33	An	Furr. Vend. Brryla plastik me termongjitje 1/2 e 3/4"	cope			
34	An	Furr. Vend. Tia plastik me termongjitje 1/2 e 3/4"	cope			
35	An	Furr. Vend. manikota plastik me termongjitje 1/2 e 3/4"	cope			
36	An	Furr. Vend. hollandez plastik me termongjitje 1/2 e 3/4"	cope			
37	An	Furr. Vend. xhunto plastik me termongjitje 1/2 e 3/4"	cope			
38	2.524	F.V element radiator me llamarine 600x200 mm	cope			
39	2.527	Termoizolim tubacione Ø ~ 50mm, me lesh xhami, beze, k katrama e bitum	m2			
40	2.531	Termoizolim tubo, boje minio,material termoizolues,rrjete, azbest,etj.	m2			
41	2.534	Termoizolim tubo pambuk mineral, material termoizolues,rrjete, azbest, etj.	m2			
42	2.535/1	Termoizolim tubo lesh xhami,material termoizolues,rrjete, etj.	m2			
43	2.535/a	Termoizolim me lesh xhami	m2			
44	2.519	Tub kanalizimi pvc Ø 90 mm	ml			
45	2.520	Tub kanalizimi pvc Ø 110 mm	ml			
46	An	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=110 mm	ml			
47	An	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=125 mm	ml			
48	An	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=160 mm	ml			
49	An	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=200 mm	ml			
50	An	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=250 mm	ml			
51	3.An/1t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm	ml			
52	3.An/2t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm	ml			
53	3.An/3t	F V tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=500 mm	ml			
54	2.407	Kapak pusete b/arne 80x80cm	m2			
55	An	Kapak pusete gize per puseta shiu	cope			
56	An	Kapak pusete gize Ø 60mm	cope			
57	An	Pastrim e çbllokim i Lavamanave	cope			
58	An	Pastrim e çbllokim i pusetave Ujra te zeza e te bardha	cope			
59	An	Riparime te ndryshme hidraulike	op			
60	An-55	F V tub drenazhi Ø 150 mm	ml			
61	An	Punime riparim i rrjetit Gjellbrimit	op			
62	An-20	Puseta shkarkimi 80x80cm, h=1.5m	cope			
63	An-23	Puseta b/a shiu 40x60cm, h=1.0m me kapak gize	cope			
		<b>Shuma 8</b>				
		<b>IX. RIPARIM E MIRËMBAJTJE ELEKTRIKE</b>				
1	480/1	F.V tub plastmasi Ø 14 ~ 17 mm	ml			
2	480/3	F.V tub plastmasi Ø 22 ~ 26 mm	ml			
3	2.481/1	F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2	ml			
4	2.481/2	F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2	ml			

## Dokumenta Standarde të Tenderit

5	2.481/3	F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm2	ml			
6	2.481/4	F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm2	ml			
7	2.482/1	F.V percjelles PPV, Ø 2 x 1.5 mm2	ml			
8	An	F.V percjelles PPV, Ø 2 x 2.5 mm2	ml			
9	An	F.V percjelles PPV, Ø 2 x 4.0 mm2	ml			
10	An	F.V percjelles PPV, Ø 5 x 4.0 mm2	ml			
11	An	F.V percjelles PPV, Ø 5 x 6.0 mm2	ml			
12	2.485	F.V Çelsa e priza 10 A me nulifikim	cope			
13	2.486	F.V Portollampa normale 10 A	cope			
14	2.487	F.V Kutiderivacioni plastike	cope			
15	2.487/c	F.V kuti suport pllaket 2 modular Gevis	cope			
16	2.485/g	F.V priza shuko brenda murit 2 fazore 25 A "Gevis"	cope			
17	2.485/5	F.V Çeles 2 polar 220V 10A "Gevis"	cope			
18	2.490/d	F.V Kasete plastike KE me 12 modular (vende)	cope			
19	2.490/2	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A, dl=0.03A	cope			
20	2.490/1b	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 16A	cope			
21	2.490/1c	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 32A	cope			
22	2.490/1e	F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 63A	cope			
23	2. a-130	Ndricues tip plafoniere ,me llampe fluoreshente 40w,	cope			
24	2. a-132	Ndricues tavanor fluoreshente 1x40w	cope			
25	An	Ndricues tavanor fluoreshente 4x60w	cope			
26	2. a-133	Ndricues tavanor fluoreshente 1x18w	cope			
27	2. a-134	Ndricues plafoniere bracete 1x40W	cope			
28	2. a-135	Ndricues tip spot me llampa fluoreshente,2x18w	cope			
29	An	Ndricues tip spot me llampa fluoreshente,2x36w	cope			
30	2. a-136	Ndricues pllafonier muror 1x60w	cope			
31	2. a-137	Ndricues fluoreshent 4x18w,IP40	cope			
32	2. a-138	Ndricues fluoreshent 2x40w,IP40	cope			
33	An	F.V Llampja te zakonshme led 20W	cope			
34	An	F.V Llampja te zakonshme led 40W	cope			
35	An	F.V. pervprozhektor te jashtem 400W	cope			
36	An	F.V. llampa per prozhektor te jashtem 400W	cope			
37	An	Riparime elektrike (çelsa, priza, kuader, shperndares etj.)	op			
		<b>Shuma 9</b>				
		<b>Shuma 1 ~ 9</b>	leke			
		<b>T.V.SH 20 %</b>	leke			
		<b>Shuma</b>	leke			

**Shtojca 14.**

[ *Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>4</sup>**

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>4</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.



**Shtojca 15**

[ *Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

**Shtojca 16**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_

Dokumenta Standarde të Tenderit

(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

\_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 17**

## **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS**

### **Punët –Kërkesë për propozim**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha

bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontratës. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

